

**BULETIN I VENDIMEVE
GJYQËSORE**

VOLUMI 4

(Korrik – Dhjetor 2018)

Tabelë Përmbledhëse

1.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PROCEDURËN E ANKIMIT	4
2.	MATERIALE REFERIMI	4
3.	PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE.....	5
3.1.	PAVLEFSHMËRI ABSOLUTE	5
3.1.1.1.	Vendim nr. 2697, datë 28.06.2018	5
3.1.1.2.	Vendimi nr. 3285, datë 21.09.2018	7
3.1.1.3.	Vendim nr. 3968, datë 08.11.2018	9
3.2.	PAVLEFSHMËRI RELATIVE	11
3.2.1.	ÇËSHTJE TË KONTROLLIT TATIMOR	11
3.2.1.1.	Vendim nr. 4164 Datë 19.11.2018.....	11
3.2.2.	ÇËSHTJE TË HETIMIT TATIMOR	27
3.2.2.1.	Vendim nr. 2752, datë 06.07.2018	27
3.2.2.2.	Vendim nr. 3161, datë 17.09.2018	29
3.2.2.3.	Vendim nr. 1055, datë 18.09.2018	30
3.2.2.4.	Vendim nr. 3356, datë 27.09.2018	32
3.2.3.	ÇËSHTJE TË TJERA.....	37
3.2.3.1.	Vendim nr.3606 , datë 15.10.2018	37
3.2.3.2.	Vendim nr.1425 , datë 13.11.2018	38

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PROCEDURËN E ANKIMIT

Sipas përcaktimeve në Kreun XI, të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kur tatimpaguesi nuk është dakord me një akt administrativ dhe beson se Administrata Tatimore nuk e ka zbatuar në mënyrë korrekte ligjin, ka të drejtën e ankimit në Drejtorinë e Apelit Tatimor (DAT) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke kërkuar shqyrtimin e pavarur të çështjeve që lidhen me këtë akt.

Drejtoria e Apelit Tatimor është përgjegjëse për kryerjen e një shqyrtimi të drejtë dhe të paanshëm të të gjitha ankesave të iniciuara pranë Ministrisë së Financave sipas legjislacionit në fuqi. Për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e apeliteve tatimore, për vlera mbi 20.000.000 lekë, në Ministrinë e Financave është ngritur Komisioni për Shqyrtimin e Apelit Tatimor (KSHAT), në përbërje të të cilit janë 7 anëtarë, tre përfaqësues të Ministrisë së Financave, dy përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtori i Apelit Tatimor dhe një përfaqësues i Avokaturës së Shtetit. Tatimpaguesi ka të drejtë gjithashtu, të ankohet në rrugë administrative në Drejtorinë Rajonale, apo në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për çdo veprim apo mosveprim të zyrtarëve tatimorë, që mund të shkelin të drejtat e tatimpaguesit. Dërgimi i ankimit pranë DAT është hapi i parë në procesin e apelit/ankimit. Ky hap duhet të merret përpara se ankesa të paraqitet në gjykatë.

Nëse tatimpaguesi nuk pajtohet me vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor, ka të drejtën ta kundërshtojë atë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Nëse nuk pajtohet me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, mund ta ankimojë atë (vendimin) në Gjykatën Administrative të Apelit.

2. MATERIALE REFERIMI

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>.

Qasja e lirë në legjislacionin dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në ndërfaqen “Legjislacioni”, në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni>.

Shënim!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

3. PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

3.1. PAVLEFSHMËRI ABSOLUTE

3.1.1.1. Vendim nr. 2697, datë 28.06.2018

Paditës: Subjekti AB

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë

Objekti: Deklarimi i pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit nr. _____ prot, datë 04.11.2014, për pagesën e TVSH-së dhe interesa në shumën 621.876 lekë.

Deklarimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. _____ prot, datë 19.07.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: 621.876 lekë.

Baza Ligjore: Nenet 32, 153, 154 të K.Pr.Civile, Neni 108 i K.Pr.Administrative, Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”; neni 71, Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Përmbledhje e fakteve: Subjekti XXX, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me kërkesë padinë me objekt: Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit Nr. _____ prot, datë 04.11.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, duke kundërshtuar rivlerësimin e bërë për TVSH-në në shumën 621.876 lekë. Ky njoftim vlerësimi është nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë si shkak i rivlerësimit të kryer nga inspektori i vlerësimit, i cili ka nxjerrë aktin e rivlerësimit për TVSH-në nr. _____ prot, datë 03.11.2014, bazuar në tre aktet e konstatimit të mbajtur nga inspektorët e sektorit të verifikimit në terren, të Administratës Tatimore, përgjatë muajit Gusht 2014.

Konkretisht, referuar të dhënave të mbledhura gjatë verifikimit në vend të evidentuara në aktet e konstatimit të mbajtura, rezulton se subjekti ka një xhiro mesatare prej 58.833 lekë në ditë. Në raportin e kasës fiskale rezulton një xhiro mesatare ditore prej 7010 lekë. Për diferencën e krijuar në shumën 51.823 lekë është bërë vlerësim tatimor nga zyra nga inspektori i vlerësimit. Pas rivlerësimit të kryer është llogaritur detyrimi për këtë subjekt në zërin TVSH në shumën 310.938 lekë si dhe një gjobë në zërin TVSH në masën 100 % të detyrimit, në shumën 310.938 lekë, gjobë e cila është vendosur në zbatim të nenit 116 të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në vijim të këtij Akt Rivlerësimi nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë është vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore duke nxjerrë Njoftim Vlerësimin për detyrimet tatimore nr.____ prot, datë 04.11.2014, për detyrimet në total 621.876 lekë. Subjekti XXX ka ankimuar në DAT Tiranë Njoftim Vlerësimin e nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, e cila pasi ka marrë në shqyrtim këtë ankim me vendimin e saj nr.____ prot, datë 19.07.2016 në të cilin ka vendosur: Refuzimin e ankimit, pasi kërkesa për apelim nuk është paraqitur brenda afatit ligjor nga data kur Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ prot, datë 04.11.2014, konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

Më pas kjo shoqëri ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, pasi mori në shqyrtim këtë çështje me vendimin e saj nr. _____, datë 10.11.2016, vendosi:

Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr.____ prot, datë 04.11.2014, për pagimin e TVSH-së dhe interesat në shumën 621.876 lekë. Rrëzimin për pjesën tjetër të objektit të padisë.

Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

Pas ankimit të paraqitur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, kjo gjykatë me vendimin e saj nr. _____, datë 28.06.2018, ka analizuar dhe vlerësuar si më poshtë;

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka vlerësuar dhe arsyetuar se vendimi nr. _____, datë 10.11.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, është i drejtë dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Kolegji vlerëson se shkaqet e ngritura në ankim nga pala e paditur në lidhje me vendimin objekt gjykimi nuk qëndrojnë, pasi me të drejtë gjykata ka arritur në konkluzionin se prej palës së paditur janë lejuar shkelje të rënda procedurale të cilat çojnë në pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr._____, datë 04.11.2014.

Në analizë kolegji konkludon se akti administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore është nxjerrë në kundërshtim me parashikimet e ligjit të posaçëm 9920/2008 ‘Për Procedurat Tatimore në R.SH’, i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.24/2008 të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Në rastin konkret rezulton se inspektorët e palës së paditur kanë kryer kontroll në bazë të Urdhrave ditorë në datat 02.08.2014, 05.08.2014 dhe 13.08.2014 nga ku ka rezultuar se: Subjekti është i regjistruar, janë evidentuar punonjësit e gjetur në punë, është i pajisur me kasë fiskale, mallrat janë

me faturë tatimore, ka të afishura çmimet, ka 25 dhoma nga të cilat në aktin e datës 02.08.2014 ishin zënë 2 dhoma, në aktin e datës 05.08.2014 ishin zënë 5 dhoma dhe në aktin e datës 13.08.2014 ishin zënë të gjitha dhomat. Aktet e konstatimit janë firmosur rregullisht nga subjekti i kontrolluar.

Mbi bazën e këtyre verifikimeve në vend pala e paditur ka bërë akt rivlerësimin nga zyra në lidhje me TVSH-në e subjektit, mbi të cilin ka dalë dhe Njoftim Vlerësimi. Pala e paditur ka përdorur metodën alternative të vlerësimit duke rivlerësuar xhiron ditore të palës paditëse, duke mos pasur një urdhër nga drejtori për kryerjen e rivlerësimit duke vepruar në kundërshtim me nenet 68, 71, 72 të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar, pika 71.2 e tij përcakton se: Aplikimi i metodave alternative të vlerësimit tatimor sipas gërmave b, c dhe dh) të nenit 71 të ligjit bëhet pasi është marrë një vendim me shkrim nga drejtori i drejtorisë tatimore.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se administrata tatimore që ka hartuar aktin e rivlerësimit tatimor ka kryer një rivlerësim të TVSH-së pa kryer këtë procedurë ligjore dhe pa marrë miratimin me shkrim të Drejtorit të Drejtorisë Tatimore, çka do të thotë se kanë shkelur detyrimin e parashikuar në nenin 72 pika 1 shkronja c, ç të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky fakt çon në pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. _____ prot, datë 04.11.2014 për pagesën e TVSH-së në shumën 621.876 lekë.

Për sa u arsyetua, Kolegji Administrativ vlerëson se vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka respektuar drejt normat procedurale të gjykimit dhe ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material.

Për këto arsye Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vendosi:

Vendim:

Lënien në fuqi të vendimit nr. _____ datë 10.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

3.1.1.2. Vendimi nr. 3285, datë 21.09.2018

Paditës: Shoqëria “AB” sh.p.k

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

Objekti: Konstatimi si absolutisht i pavlefshëm i aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. _____ Prot., datë 17.11.2014, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

Shuma e detyrimit tatimor: 1.513.392 lekë

Baza Ligjore:

1. Nenet 7, 11, 15, 17/a të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative ", i ndryshuar;
2. Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar.

Përmbledhje e Fakteve: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me Vendimin Nr. ____ datë 12.06.2015, ka vendosur: "Rrëzimin e Padisë". Kundër këtij Vendimi ka paraqitur Ankim Shoqëria "AB" shpk, me argumentet se Gjykata ka zbatuar gabim ligjin pasi 3 punonjësit për të cilët ky i fundit është gjobitur janë larguar nga puna përkatësisht në datë 04.08.2014 dhe me datë 30.08.2014. Akti administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore Nr. ____ prot, datë 17.11.2014, i cili është mbështetur në Aktin e Konstatimit nr.____, datë 08.09.2014, është i pavlefshëm, pasi akti i konstatimit është plotësuar në kundërshtim me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, duke shkelur mënyrën e verifikimit dhe kontrollit.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata Administrative e Apelit vë në dukje *in primis* se në objektin e padisë, nga pala paditëse, shoqëria "XXX" shpk, pretendohet pavlefshmëria absolute e Njoftim Vlerësimit Tatimor (NJVT) Nr. ____ Prot, datë 17.11.2014, i nxjerrë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës. Në këto kushte, në rastin në gjykim (*de quo*), çështja e ezaurimit të rrugës administrative apo afati i kundërshtimit të aktit administrativ në gjykatë, nuk paraqesin rëndësi, në vështrim të nenit 18 pika 8, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit, pavlefshmëria absolute e akteve administrative mund të pretendohet në çdo kohë.

Ky kolegji vë në dukje se një akt absolutisht i pavlefshëm, konsiderohet në kundërshtim flagrant me ligjin, shkelje e cila vlerësohet në një masë të tillë sa e bën aktin inekzistent nga pikëpamja juridike. Meqënëse një akt i tillë vlerësohet se nuk ka sjellë asnjëherë pasoja juridike (neni 117, pika 1 e K.Pr.Administrative), situatat që përbëjnë pavlefshmëri absolute janë përcaktuar nga ligji në një listë shteruese në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjykata e Apelit vlerëson se, në kundërshtim me sa ka pretenduar në ankim pala paditëse, NJVT Nr. ____ Prot, datë 17.11.2014 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, nuk është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të nenit 116 të K.Pr.Administrative, për pasojë vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë, duhet të mbetet i pacënuar. Faktet e pretenduara nga pala paditëse se, inspektorët tatimorë nuk kanë identifikuar të gjithë punëtorët që ndodheshin në çastin e kontrollit, nuk lidhet me pavlefshmërinë absolute të njoftim vlerësimit tatimor, por me zbatimin e ligjit nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, pra me ligjshmërinë dhe themelësinë e aktit administrativ (pavlefshmërinë relative të tij).

Vendim:

Lënien në fuqi të vendimit Nr. ____, datë 12.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës.

3.1.1.3 Vendim nr. 3968, datë 08.11.2018

Paditës: “AB”

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti: Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit “Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor nr. _____, datë 11.05.2014” i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe Vendimit nr. _____, datë 16.09.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: 980.387 Lekë.

Baza Ligjore:

1. Neni 115 i Kodit të Procedurave Administrative,
2. Udhëzimi nr.1240/4, datë 15.09.2009 ndryshuar me Udhëzimin nr.4196/1, datë 17.03.2011 dhe,
3. Udhëzimi nr.1240/5, datë 15.09.2010.

Përmbledhje e Fakteve:

Paditësi XXX është i licensuar si profesionist i lirë, përmbarues gjyqësor. Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore -Tiranë kanë ushtruar kontroll tatimor – vizitë fiskale pranë paditësit në datat 08-10.05.2014.

Pas përfundimit të kontrollit, paditësit i është komunikuar raporti paraprak i kontrollit me shkresën _____ prot, datë 16.05.2014 në të cilin pasqyroheshin detyrimet tatimore të llogaritura nga inspektori i kontrollit.

Pas shqyrtimit të kundërshtimeve të paditësit në lidhje me përmbajtjen e raportit paraprak të kontrollit, paditësit i është komunikuar nga ana e palës së paditur raporti përfundimtar i kontrollit të datës 09.06.2014 në të cilin pala e paditur i ka dhënë përgjigje pretendimeve të tatimpaguesit duke konfirmuar detyrimet e nxjerra në raportin e kontrollit paraprak.

Me njoftim vlerësimin e detyrimit tatimor nr. _____, datë 11.06.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, paditësi është njoftuar se kishte detyrime tatimore për të paguar në shumën prej 980.387 Lekë. Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin nr. _____, datë 16.09.2014, ka refuzuar ankimin kundër aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi i Detyrimit Tatimor” nr. _____, datë 11.06.2014 ndaj paditësit, me arsyetimin se ankimi është në tejkalim të afatit ligjor, si dhe nuk është përmbushur/ parapaguar detyrimi tatimor.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit konstaton se shkak për lindjen e mosmarrëveshjes është “Njoftim Vlerësimi i Detyrimeve Tatimore” nr. _____, datë 11.06.2014, ndaj të cilit është refuzuar shqyrtimi i ankimit administrativ me vendimin nr. _____, datë 16.09.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Gjithashtu me padinë e paraqitur për shqyrtim, paditësi ka kërkuar pavlefshmërinë absolute të shkresës nr._____, datë 11.05.2014 me të cilën paditësit i është komunikuar raporti përfundimtar i kontrollit i datës 09.06.2014.

Në kreun IV të Ligjit Nr.49/2012 me titull “Subjektet dhe kushtet formale të padisë”, në nenin 17 të tij përcaktohet se:

“Padia ngrihet: a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;

c) për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;”

Në nenin 2.2 të ligjit nr.49/2012 përcaktohet se: *“Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”,* ndërsa në pikën 8 të tij përcaktohet se: *“Veprim tjetër administrativ” është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik, në kryerjen e funksionit publik dhe që nuk plotëson kushtet për të qenë akt administrativ apo kontratë dhe që krijon pasoja juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshëm”.*

Gjykata konstaton se, shkak për ngritjen e padisë para gjykatës administrative duhet të jetë nxjerrja e një akti administrativ, apo kryerja e një veprimi tjetër administrativ nga organi administrativ, me të cilët krijohen, ndryshohen apo shuhen marrëdhënie juridike me pasoja për paditësin, apo mosveprimi i organit administrativ, nëpërmjet heshtjes kur ai ka pasur detyrim ligjor të veprojë nëpërmjet nxjerrjes së një akti administrativ.

Gjykata vlerëson se shkresa nr._____, datë 11.06.2014 me anë të së cilës paditësit i është komunikuar raporti përfundimtar i kontrollit i datës 09.06.2014 nuk përbën një akt administrativ, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr.49/2012 dhe Kodit të Procedurave Administrative, në fuqi në kohën e nxjerrjes së kësaj shkrese.

Shkresa nr._____, datë 11.05.2014 përfaqëson veçse një akt korrespondence me karakter informues, lidhur me konkluzionet e raportit përfundimtar të kontrollit, ndërkohë që akti administrativ i cili ka sjellë pasoja për paditësin ka qenë njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr._____ prot, datë 11.06.2014.

Duke qenë se paditësi me padinë objekt gjykimi ka kundërshtuar një shkresë, e cila nuk i plotëson kushtet ligjore për t’u konsideruar akt administrativ, padia e tij për konstatimin e pavlefshmërisë së shkresës nr._____, datë 11.06.2014 nuk i plotëson kushtet formale të përcaktuara në nenin 17a dhe 17c të ligjit nr.49/2012 për t’u marrë në shqyrtim në një gjykim administrativ.

Vendim:

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin nr.3968, dt.08.11.2018, ka vendosur: **Pushimin e gjykimit të çështjes.**

3.2. PAVLEFSHMËRI RELATIVE

3.2.1. ÇËSHTJE TË KONTROLLIT TATIMOR

3.2.1.1. Vendim nr. 4164 Datë 19.11.2018

Paditës: Shoqëria “AB” sh.p.k, NIPT

I paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

Objekti: Shfuqizim i njoftim vlerësimit nr.xxxx/3 prot datë 28.03.2011 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër për shoqërinë “AB” sh.p.k si dhe shfuqizim i vendimit nr.xxxx/4 prot datë 19.08.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë për uljen e tepricës kreditore të t.v.sh-së për periudhën tatimore 2009/06 deri 2010/10, bazuar në Raport kontrollin datë 17.11.2010 dhe 21.03.2011 si dhe rimbursimin e T.v.sh-së së kreditueshme për periudhën tatimore 2009/06 deri 2010/10”

Shuma e detyrimit tatimor: 30 547 669 lekë

Baza Ligjore: Ligji nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, Ligji nr.8438 dt.28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimi nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ligji nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.17 datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar,

Përmbledhje e Fakteve: Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është zhvilluar gjykimi i çështjes gjyqësore me palë paditëse Shoqëria “AB” sh.p.k, NIPT, palë e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, me objekt gjykimi “shfuqizim i njoftim vlerësimit nr.xxx/3 prot datë 28.03.2011 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër për shoqërinë “AB” sh.p.k si dhe shfuqizim i vendimit nr.9293/4 prot datë 19.08.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë për uljen e tepricës kreditore të t.v.sh-së për periudhën tatimore 2009/06 deri 2010/10, bazuar në Raport kontrollin datë 17.11.2010 dhe datë 21.03.2011 si dhe rimbursimin e T.v.sh-së së kreditueshme për periudhën tatimore 2009/06 deri 2010/10”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.1576 (2792) datë 27.06.2013, nëpërmjet të cilit vendosi:

1.Pranimin e kërkesë-padisë

2.Anullimin e vendimit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër për ulje të tepricës kreditore për tatimin mbi vlerën e shtuar për shoqërinë “AB” sh.p.k për periudhën qershor të vitit 2009 - shtator të vitit 2010, të shprehur me njoftim vlerësimit nr.xxx/3 prot datë 28.03.2011 dhe anullimin e pikës (1) të vendimit Nr.9293/4 prot, datë 19.08.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

3.Detyrimin e palës së paditur që t'i rimbursojë palës paditëse tepricën kreditore për tatimin mbi vlerën e shtuar për periudhën qershor 2009 - shtator 2010.

4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Mbi bazën e ankimimit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër çështja është kaluar për gjykim në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr.443 datë 28.01.2014 ka vendosur :

Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Shkodër për shqyrtimin e çështjes,

Dërgimin e akteve në Gjykatën Administrative të Apelit si gjykatë kompetente.

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e saj nr.3149 datë 17.07.2014 ka vendosur :

Prishjen e vendimit Nr.1576 (2792) datë 27.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjyimit të çështjes.

Ndaj vendimit të sipërcituar ka paraqitur Rekurs drejtuar Gjykatës së Lartë pala paditëse Shoqëria “AB” sh.p.k.

Gjykata e Lartë me vendimin e saj Nr.31001-00223-00-2015 Regj.Themeltar, Nr.00-2016-2562 Vendimi (396) datë 29.06.2016 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.3149 datë 17.07.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Shoqëria “AB” sh.p.k është subjekt në administrim të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me numër Nipti NIPT, me objekt aktiviteti “telefoni, aktivitet në fushën e telekomunikacioneve, projektim dhe zbatim netëork, trafik ndërkombëtar impulsesh”, adresë të deklaruar aktiviteti Bushat, Shkodër.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka ushtruar kontroll në Shoqërinë “AB” sh.p.k duke përpiluar fillimisht Aktin e kontrollit datë 17.11.2010, Proçesverbalet bashkëngjitur tij, i cili i është bërë i ditur subjektit, nënshkruar, firmosur nga vetë subjekti.

Detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor janë të përcaktuara qartë në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në RSH-së”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, “Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qëndrore”.

Në zbatim të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar subjektit i njëhej e drejta e kundërshtimit të aktit të kontrollit, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për të, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.

Nga organi tatimor në vijim është bërë dhe një Shtesë Akt kontrolli datë 21.03.2011, komunikuar subjektit me shkresën nr.xxx/2 prot datë 21.03.2011.

Sipas inspektorit të kontrollit i është dashur kohë për t’u konsultuar duke pasur parasysh *natyrën e objektit të aktivitetit të subjektit për të cilin po ushtronte kontrollin.*

Kontrolli është ushtruar mbi bazën e një Njoftimi për kontroll nr.xxx prot datë 01.11.2010, Autorizimi për kryerjen e kontrollit datë 01.11.2010 dhe Programi për kontroll sipas të cilit subjekti do të

kontrollohej për **tatimin mbi vlerën e shtuar dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 09/2009 deri 10/2010.**

Mbi bazën e këtij kontrolli, përfshirë dhe aktin shtesë subjekti në vijim është njoftuar nga organi tatimor me njoftim-vlerësimin nr.xxx/3 prot datë 23.03.2011, nr.xxx/3 prot datë 28.03.2011 për detyrimet tatimore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në këto akte sipas zërit tatimor, tatim mbi vlerën e shtuar dhe periudhës tatimore përkatëse.

Sipas aktit të kontrollit është bërë argumentimi i gjendjes kreditore të T.v.sh-së së deklaruar nga subjekti deri më 30.10.2010, të dhënat në këtë akt.

- **Sipas aktit të kontrollit datë 17.11.2010, procesverbalit Nr.1 datë 17.11.2010**

bashkëngjitur tij të mbajtur nga inspektori i kontrollit, gjatë kontrollit të ushtruar ka rezultuar si më poshtë :

Fatura nr.xx datë 06.07.2009 me vlerë 167.390 lekë e deklaruar nga subjekti në shtator të vitit 2009 është konstatuar fotokopje dhe e pakuptueshme prandaj nuk i është njohur si shpenzim dhe është rivlerësuar situata financiare e subjektit për 167.390 lekë x 20 % = 33.478 lekë T.v.sh, vlerësuar në zbatim të Ligjit nr.7928 datë 27.04.1995, i ndryshuar, neni 41 pika (c) si dhe subjekti është sanksionuar me gjobë në vlerën 10.000 lekë për “pasaktësi të plotësimit të deklaratës tatimore”, bazuar në ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115.

Në Ligjin nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 41 “Vlerësimet tatimore” shprehet:

1. Administrata tatimore ka të drejtë të bëjë një vlerësim tatimor të shumës së TVSH-së kur:

a) personi nuk bën deklarin nga ajo periudhë kohe apo në formën, që përcaktohet në këtë ligj;

b) personi kërkon që shuma e TVSH-së e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë, të ndryshojë, për arsye të një gabimi a mangësie;

c) çmon se shuma e TVSH-së e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë të bërë nga një person i tatueshëm është më e vogël se shuma që duhej të ishte pasqyruar si e pagueshme

- **Sipas aktit të kontrollit datë 17.11.2010, procesverbalit Nr.2 datë 17.11.2010**

bashkëngjitur tij të mbajtur nga inspektori i kontrollit, gjatë kontrollit të ushtruar ka rezultuar si më poshtë :

Ishin deklaruar blerje të tatueshme për muajin korrik 2010 nga subjekti vlera 755.085 lekë, fatura për të cilën është konstatuar e paqartë dhe fotokopje.

Për këtë arsye nga inspektori i kontrollit është rivlerësuar situata financiare e subjektit për 755.085 lekë x 20 % = 151.017 lekë T.v.sh, vlerësuar në zbatim të ligjit nr.7928 datë 27.04.1995, i ndryshuar, neni 41 pika (c) si dhe subjekti është sanksionuar me gjobë në vlerën 10.000 lekë për “pasaktësi të plotësimit të deklaratës tatimore”, bazuar në ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115.

Vlerësimi është kryer bazuar në nenin 68 të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku administratës tatimore i jepet e drejta e kryerjes së vlerësimit të detyrimit tatimor, i cili bazohet përveç të tjerave dhe në rezultatet e një kontrolli.

Dokumentacioni i parregullt është konstatuar nga inspektori i kontrollit gjatë verifikimit të faturave të blerjeve të shoqërisë dhe analizës së shpenzimeve përkatëse, të cilat kanë ndikuar në përcaktimin e fitimit të tatueshëm.

Neni 68 i ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Vlerësimi tatimor” shpreh :

1. Vlerësimi tatimor :

a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore

b) në rastet kur shuma e detyrimit tatimor të vetëdeklaruar nuk paguhet, është njoftimi, që kërkon pagesën e detyrimit tatimor në datën e përcaktuar në ligjin përkatës.

2. Nëse tatimpaguesit i kërkohet të dorëzojë deklaratë tatimore dhe të paguajë detyrimin tatimor, deklarata merret si vetëvlerësim tatimor.

Pagesa e tatimit bëhet në mënyrën dhe afatin e parashikuar në ligjin tatimor përkatës.....

4. Nëse administrata tatimore vëren se detyrimi tatimor, i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore bën vlerësimin tatimor.

5. Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës.

Vlerësimi bazohet në :

a) informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit

b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji

c) mënyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji.

Ligji nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 68 vlerësimi tatimor dhe Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 në zbatimin e tij pika 68.3.1 ka përcaktuar:

Administrata tatimore ka autoritetin dhe detyrimin për të mbikëqyrur të gjithë procesin e vlerësimit të detyrimeve tatimore të personave të tatueshëm. Ajo mund të bëjë një vlerësim të detyrimit tatimor të personit të tatueshëm, në rastet e mëposhtme.

b) Kur administrata tatimore vëren se detyrimi tatimor, i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë. Në këtë rast vlerësimi tatimor bazohet në informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit ose në rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të ligjit ose në mënyrat alternative të vlerësimit të parashikuara në nenin 72 të ligjit.

Në Ligjin nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 41 “Vlerësimet tatimore” shprehet :

1. Administrata tatimore ka të drejtë të bëjë një vlerësim tatimor të shumës së TVSH-së kur:

a) personi nuk bën deklarin nga ajo periudhë kohe apo në formën, që përcaktohet në këtë ligj;

b) personi kërkon që shuma e TVSH-së e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë, të ndryshojë, për arsye të një gabimi a mangësie;

c) çmon se shuma e TVSH-së e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë të bërë nga një person i tatueshëm është më e vogël se shuma që duhej të ishte pasqyruar si e pagueshme

Kontrolli është bërë mbi bazën e një njoftimi për kontroll sikurse sqaruar më lart, firmosur nga vetë subjekti, gjatë kësaj procedure është kontaktuar me subjektin nga inspektori i kontrollit, të cilit vetë subjekti i ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar për kontroll, ai është vënë në dijeni të të gjitha fakteve dhe vlerësimeve duke pasur mundësi të komunikojë, përfshirë dhe formën shkresore zyrtare.

Dokumentacioni i parregullt është konstatuar nga inspektori i kontrollit gjatë verifikimit të faturave të blerjeve të shoqërisë të vëna në dispozicion nga vetë tatimpaguesi.

Nga ky verifikim është konstatuar, se këto fatura nuk përmbanin të gjithë elementët e përcaktuara në paragrafin 11.1 të Udhëzimit nr.17 datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, siç janë emri i subjektit, nipti i gabuar, emri i blerësit, mungesa e firmës etj.

Në Udhëzimin nr.17 datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, paragrafi 11.1 është përcaktuar:

Faturat janë dokumenti bazë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Ato përcaktojnë detyrimin tatimor të furnizuesit dhe shumën e tatimit të zbritshëm që do ti lejohet të kërkojë blerësi i regjistruar për TVSH.

Fatura, e cila prodhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sipas formularit tip bashkëngjitur këtij udhëzimi, duhet të përmbajë:

- numrin rendor, numrin serial të parashtypur, datën e lëshimit, emrin, adresën, numrin e

identifikimit të shitësit, emrin, adresën, numrin e identifikimit të blerësit, emrin dhe adresën e blerësit, në rastin e individëve (për shitje me pakicë me vlerë mbi 10 mijë lekë), emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit, përshkrimin e hollësishëm të mallrave të shitura ose të shërbimeve të kryera, sasinë e mallrave të shitura ose vëllimin e shërbimeve të kryera, çmimin për njësi pa TVSH, vlerën totale të transaksionit pa TVSH, shumën e TVSH-së (nëqoftëse zbatohet TVSH), vlerën totale me TVSH, cilësimin furnizim i përjashtuar apo me 0 përqind (nëqoftëse ai është përkatësisht i përjashtuar apo i tatueshëm me 0 përqind).....

Vetëm origjinali i faturës i jep të drejtë blerësit për të kredituar t.v.sh-në e paguar në blerje.

Për qëllime të kreditimit tatimor, në rastet kur kopja e parë origjinale humbet do të konsiderohet e vlefshme për blerësin kopja e noterizuar e fatures së blerjes, me kusht që shitësi të zotërojë origjinalin dhe ta ketë deklaruar atë.

Nëse fatura nuk përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara më lart, blerësi nuk ka të drejtë të kreditojë t.v.sh-në e paguar në blerje, kurse shitësi nga ana e tij do të paguajë T.v.sh-në e detyrueshme për tu paguar.

Referuar përmbajtjes së aktit të kontrollit shtesë datë 21.03.2011 në vazhdim të Akt kontrollit datë 17.11.2010 në lidhje me mënyrën e faturimit të impulseve, që subjekti ka bërë me subjekte jashtë shtetit nga kontrolli i gjithë dokumentacionit blerje dhe shitje rezultuan mosrakordime sipas muajve blerjet dhe shitjet.

U konstatuan diferenca të theksuara nga muaji në muaj, p.sh: nga muaji qershor 2009 blerjet me gjithë t.v.sh janë 39.963.034 lekë, ndërsa shitjet ishin 45.256.542 lekë, me një diferencë prej 5.293.508 lekë. Po kështu argumentohen mosrakordime të tjera në Aktin shtesë të kontrollit datë 21.03.2011 (komunikuar pjesë e praktikës administrative para gjykatës Gjykatës).

Po sipas aktit në muajin tetor 2009 ka deklaruar blerje 1 143 352 lekë, ka deklaruar shitje 10 174 035 lekë.

Në muajin janar 2010 ka deklaruar shitje 10 345 331 lekë, nuk ka deklaruar asnjë blerje

Në muajin korrik 2010 deklaroi blerje 0 lekë, ndërsa deklaroi shitje 16 639 564 lekë

Në fund të vlerësimit e gjithë shuma e llogaritur nga inspektori i kontrollit 192.264.180 lekë e deklaruar eksport është kaluar si shitje e përjashtuar.

Në përfundim sipas aktit të kontrollit subjektit nuk i takonte rimbursim, kjo në zbatim të Udhëzimit nr.17 datë 13.05.2008, i ndryshuar, pika 19 për kreditimin e pjesshëm.

I gjithë sistemimi, vlerësimi është bërë në bazë të ligjit nr.7928 datë 27.04.1995, i ndryshuar, Udhëzimit përkatës, në zbatim dhe të ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar....

Për detyrimin tatimor subjekti është njoftuar me njoftim vlerësimin tatimor *nr.xxx/3 prot., datë 23.03.2011, datë 28.03.2011.*

Nga inspektori i kontrollit është bërë vlerësimi i detyrimit tatimor, sipas shkeljeve të konstatuara, detyrimet e vlerësuar janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në aktin e kontrollit dhe proçesverbalet përkatëse (dorëzuar para gjykatës praktika e plotë), përfshirë Aktin shtesë.

Në vijim këto detyrime janë hedhur në sistemin informatik të organit tatimor konform proçedurave ligjore, që rezultojnë në ulje të Tepricës kreditore të subjektit dhe mbi bazën e të dhënave është nxjerrë njoftim vlerësimi tatimor nr.xxx/3 prot datë 23.03.2011, datë 28.03.2011.

Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me një kërkesë ankimore.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj komunikuar me shkresën nr.9293/4 prot., datë 19.08.2011, nëpërmjet të cilit vendos:

- Ndryshimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.xxx/3 prot., datë 28.03.2011 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në lidhje me uljen e tepricës kreditore të T.V.SH-së, në vlerë totale 30.752.164 lekë, bazuar në rezultatet e Raport kontrollit datë 17.11.2010 dhe 21.03.2011.

- Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr.xxx/3 prot datë 28.03.2011 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në lidhje me uljen e tepricës kreditore të T.V.SH-së si dhe penalitetin për periudhat tatimore 2009/06 deri 2010/10, bazuar në rezultatet e kontrollit.
- Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr.xxx/3 prot., datë 28.03.2011 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në lidhje me uljen e tepricës kreditore të T.v.sh-së për periudhën tatimore 2010/10 dhe i lihet detyrë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër të zgjidhë çështjen, duke iu referuar trajtimit në këtë vendim.

Sipas këtij vendimi dokumentacioni që bëri prezent subjekti nuk përbën provë për kundërshtimin e vlerësimit tatimor të kryer, pasi nuk justifikon ligjërisht respektimin e kërkesave ligjore dhe për më tepër referuar dhe pretendimeve të parashtruara nga tatimpaguesi, i cili konfirmon se faturat tatimore të shitjes së impulseve janë bërë në kuptim të nenit 25.9 të ligjit nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.

Në ligjin nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 33 “Kreditimi i tatimit” shprehet:

1. Kreditimi i tatimit për një periudhë tatimore është:

a) totali i TVSH i zbatuar në lidhje me :

(i) të gjitha furnizimet e tatueshme të bëra për personin e tatueshëm gjatë periudhës tatimore nga persona të tjerë të tatueshëm;

(ii) të gjitha importet e mallrave të bëra nga personi i tatueshëm gjatë periudhës tatimore kur këto furnizime a importime janë bërë për qëllimet e furnizimeve të tatueshme të bëra ose për t’u bërë nga personi i tatueshëm;

b)çdo kreditim i tatimit i lejuar në bazë të nenit 34, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.

2. Kreditimi i tatimit nuk lejohet në asnjë rrethanë për shpenzime që nuk janë tërësisht vetëm për qëllime të veprimtarisë ekonomike.

3. Një person i tatueshëm nuk ka të drejtë të kërkojë kreditim tatimi në bazë të këtij neni, nëqoftëse ai nuk zotëron një faturë që tregon shumën e kreditimit të kërkuar ose të kërkojë kreditim tatimi në bazë të nenit 34 nëse ai nuk zotëron dokumente që vërtetojnë se borxhi është një borxh i keq.

4. Ministri i Financave cakton me udhëzim lejimin e kreditimit të tatimit për një person të tatueshëm për sa i përket një pjese të TVSH të paguar prej tij në lidhje me furnizime të tatueshme dhe importime mallrash të kryera prej tij pjesërisht për qëllime të furnizimeve të tatueshme të bëra apo për t’u bërë prej tij dhe pjesërisht për qëllime të tjera ...

Referuar kërkesave të parashikuara në Ligjin e sipërcituar neni 33 dhe Udhëzimit nr.17 datë 13.05.2008 paragrafi 18.1 ka përcaktuar, se TVSH e kreditueshme (i zbritshëm) është shuma e TVSH-se që personi i tatueshëm paguan në momentin që ai blen mallra apo shërbime brenda vendit si dhe shuma e TVSH-se që ai ka paguar për importet e bëra, me kushtin që, këto furnizime t’i shërbejnë vetëm furnizimeve të tatueshme që do të bëjë ky person i tatueshëm.

Nëse furnizimet e marra ose importet e bëra i shërbejnë furnizimeve të përjashtuara që mund të bëjë personi i tatueshëm, nuk lejohet kreditimi i TVSH së paguar në lidhje me furnizimet e marra për këto qëllime.

Nëse personi i tatueshëm i përdor furnizimet e marra ose importet e bëra edhe për qëllime të furnizimeve të tatueshme edhe për qëllime të furnizimeve të përjashtuara njëkohësisht, kreditimi i tatimit të paguar bëhet përpjesëtimisht sipas pikës 19 të këtij udhëzimi.

Udhëzimi nr.17 datë 13.05.2008, pika 19 “kreditimi i pjesshëm” ka përcaktuar:

Në mbështetje të nenit 33 pika 4, nëqoftëse një furnizim malli apo shërbimi përdoret pjesërisht për qëllime të furnizimeve të tatueshme të bëra ose për t'u bërë dhe pjesërisht për furnizime të përjashtuara, lejohet vetëm një pjesë e kreditimit të tatimit. Llogaritja e kreditimit të pjesshëm bëhet në bazë të përqindjes së kreditimit sic përcaktohet në pikën 19.1 të këtij udhëzimi

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në lidhje me këtë vendim të Drejtorisë së Apelimit Tatimor është mbajtur Akt konstatimi nr.7137/1 prot datë 23.09.2011 sipas të cilit është shfuqizuar ulja e tepicës kreditore të T.v.sh-së për periudhën tatimore 2010/10 (sipas rezultateve të Akt kontrollit objekt gjykimi).

Bazuar në vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor, në zbatim të ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji janë kryer vlerësimet përkatëse sipas Akt konstatimit nr.7137/1 prot., datë 23.09.2011 nga Drejtoria e Vlerësimit, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, deklarata e T.v.sh-së kthehet në situatën e mëparshme pas datës së hyrjes në fuqi të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.31 datë 13.09.2010 “Për përcaktimin e listës së shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar detar, ajror dhe të telekomunikacionit të mallrave dhe pasagjerëve me t.v.sh zero”.

Në fund të vlerësimeve në zbatim të Ligjit nr.7928 datë 27.04.1995, i ndryshuar, Udhëzimit nr.17 datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar pas kryerjes së kontrollit, mbi bazën dhe të kërkesës së subjektit nr.2116 prot., datë 19.03.2012 dhe asaj me nr.2558 prot., datë 27.03.2012 është kaluar për kompensim të detyrimeve të subjektit sipas shkresës nr.83/12 prot datë 05.04.2012 vlera 1.117.529 lekë.

Kompensimi është bërë për detyrimet e subjektit sipas kërkesës së tij nr.2116 prot datë 19.03.2012 dhe asaj me nr.2558 prot datë 27.03.2012 (kërkesat janë komunikuar para Gjykatës si pjesë e praktikës administrative, në të cilat shprehet në mënyrë të detajuar kompensimi i kërkuar dhe kryer në vlerën totale 1.117.529 lekë).

Nuk ishim dakord me Aktin e Ekspertimit të paraqitur nga ekspertja para Gjykatës lidhur me këtë çështje, i jemi përmbajtur vlerësimit sipas aktit të kontrollit konstatohen mospërputhje në deklaratimet e subjektit, nëpërmjet formularit të deklarimit të tatimit mbi vlerën e shtuar para organit tatimor, detyrim ligjor ky i tij për disa periudha tatimore.

Sipas vlerësimit të bërë nga inspektori i kontrollit në aspektin teknik në lidhje me aktin e ekspertimit të paraqitur nga ekspertja para Gjykatës, komunikuar para gjykatës dhe me shkresën nr.601/1 prot datë 20.05.2013 rezulton, se duke kontrolluar muaj për muaj deklarimin e subjektit para organit tatimor sipas formularit të deklarimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, FDP-ve përkatëse, gjë që është shprehur edhe në akt kontrollin e mbajtur në subjekt, arrihet në konkluzionin:

➤ për periudhën Shtator 2009 deri Dhjetor 2009

Subjekti kishte deklaruar blerje të tatueshme shumë 34 517 374 leke kjo sipas muajve

-Shtator	blerje	9 595 919 lekë	shitje	4 807 890 lekë
-Tetor	blerje	1 143 352 lekë	shitje	10 174 035 lekë
-Nëntor	blerje	9 468 114 lekë	shitje	8 802 323 lekë
-Dhjetor	blerje	14 309 989 lekë	shitje	21 409 294 lekë.

Shuma 2009 = 34 517 374 lekë - 45 193 542 lekë, diferenca + 10 676 168 lekë

Ka shitur më shumë se ka blerë 10 676 168 leke, ka muaj që ka blerë në Tetor 2009 =

1 143 352 lekë dhe ka shitur 10 174 035 lekë ?

Për periudhën Janar 2010 deri Tetor 2010 subjekti ka deklaruar blerje 120 341 924 lekë dhe ka shitur 192 617 180 lekë, kjo sipas muajve :

- Janar	blerje	0 lekë	shitje	10 345 331 lekë
- Shkurt	blerje	17 224 370 lekë	shitje	15 380 840 lekë
- Mars	blerje	9 851 111 lekë	shitje	9 936 606 lekë
- Prill	blerje	21 226 386 lekë	shitje	29 429 346 lekë
- Maj	blerje	11 488 357 lekë	shitje	23 315 432 lekë
- Qershor	blerje	10 073 127 lekë	shitje	19 245 068 lekë
Korrik	blerje	906 102 lekë	shitje	16 639 564 lekë
- Gusht	blerje	29 499 236 lekë	shitje	26 142 841 lekë
- Shtator	blerje	14 434 890 lekë	shitje	20 803 490 lekë
- Tetor	blerje	5 638 345 lekë	shitje	21 378 662 lekë
Shuma		120 341 924 lekë		192 617 180 lekë

Subjekti ka shitur më shumë se ka blerë 72 275 256 lekë.

Sipas aktit të ekspertimit shprehet, se në muajin Janar 2010 subjekti ka blerje **12 426 802** lekë, ndërsa subjekti deklaroi **0** lekë blerje nëpërmjet deklarimit të tij para organit tatimor, detyrim ligjor ky i tij (shih formularin e situatës fiskale të komunikuar para Gjykatës për këtë periudhë).

Sipas aktit të ekspertimit shprehet, se ka blerje në muajin Korrik 2010 në shumë **20 357 064** lekë, subjekti deklaroi blerje **755 085** lekë (shih formularin e situatës fiskale të paraqitur para Gjykatës)....

Pra nuk kemi qenë dakord me Aktin e ekspertimit paraqitur para gjykatës duke i qëndruar vlerësimit sipas aktit të kontrollit.

Detyrimet tatimore të vlerësuara, përcaktuara sipas këtij akt kontrolli vlerësohen si të bazuara në ligjet e referuara në këtë Akt dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti në kohën e kryerjes së kontrollit.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.1576 (2792) datë 27.06.2013, nëpërmjet të cilit vendosi:

1.Pranimin e kërkesë-padisë

2.Anullimin e vendimit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër për ulje të tepricës kreditore për tatimin mbi vlerën e shtuar për shoqërinë “AB” sh.p.k për periudhën qershor të vitit 2009 - shtator të vitit 2010, të shprehur me njoftim vlerësimin nr.xxx/3 prot datë 28.03.2011 dhe anulimin e pikës (1) të vendimit nr.9293/4 prot datë 19.08.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

3.Detyrimin e palës së paditur që t`i rimbursojë palës paditëse tepricën kreditore për tatimin mbi vlerën e shtuar për periudhën qershor 2009 - shtator 2010

Mbi bazën e ankimimit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër çështja është kaluar për gjykim në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr.443 datë 28.01.2014 ka vendosur:

Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Shkodër për shqyrtimin e çështjes,

Dërgimin e akteve në Gjykatën Administrative të Apelit si gjykatë kompetente.

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e saj nr.3149 datë 17.07.2014 ka vendosur :

Prishjen e vendimit nr.1576 (2792) datë 27.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Ndaj vendimit të sipërcituar ka paraqitur Rekurs drejtuar Gjykatës së Lartë pala paditëse Shoqëria “AB” sh.p.k.

Vlerësimi i çështjes nga Gjykata e Lartë :

Gjykata e Lartë me vendimin e saj Nr.31001-00223-00-2015 Regj.Themeltar, Nr.00-2016-2562 Vendimi (396) datë 29.06.2016 ka vendosur :

Prishjen e vendimit nr.3149 datë 17.07.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson, se rekursi i paraqitur nga pala paditëse Shoqëria “ABs” sh.p.k, përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 58 të Ligjit nr.49/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, prandaj ekzistojnë arsye ligjore që ky vendim i gjykatës së apelit të çënohet.

Nga citimi i nenit 109/2 te ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, evidentohet se:

Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim. Nëse Drejtoria e Apelit Tatimor nuk shprehet brenda tre muajve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë.

Ndërsa në nenin 328 të K.Pr. Civile, parashikohet se :

Afati për paraqitjen e padisë ndaj një akti administrativ është tridhjetë ditë nga dita e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ, që ka shqyrtuar ankesën në rrugë administrative përveç kur ligji parashikon ankimin e drejtpërdrejtë në gjykatë. Në këtë rast afati fillon nga dita e shpalljes ose e njoftimit të aktit administrativ ndaj të cilit është paraqitur padia.

Në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara del e qartë, se palës paditëse i lindte e drejta për t'iu drejtuar gjykatës brenda afatit 30 ditor nga marrja dijani për vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor. Në rekurs pala paditëse pretendon, së Gjykata e apelit ka bërë referim te gabuar tek neni 109 pika 2, pasi në rastin objekt gjykimi nuk ndodhemi në situatën që Drejtoria e Apelit Tatimor të mos e ketë marrë në shqyrtim çështjen, por përkundrazi ajo e ka marrë në shqyrtim brenda afatit 3 mujor dhe ka dalë me një vendim, sepse me shkresën nr.9293/3 prot., datë 20.07.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor jemi njoftuar me kërkesë për plotësim dokumentacioni. Pra kjo shkresë provon që ka filluar procedimi administrativ dhe pala paditëse ka dërguar, pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor edhe provat e kërkuara prej saj...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson, se ky pretendim i paraqitur në rekurs nga pala paditëse është i pabazuar në ligj, sepse si datë fillimi për ecjen e afatit tre mujor të ankimit, të parashikuar në dispozitën ligjore të sipërpërmendur merret dita e paraqitjes së kërkesës ankimore nga subjekti tatimpagues ndaj vendimit të njoftimit vleresimit tatimor të nxjerre nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore, e cila në këtë rast ka qenë më datë 21.04.2011, ndërsa vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor është marrë më datë 19.08.2011, pra jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 109/2 të ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i cili përfundonte më datë 21.07.2011 siç me të drejte ka konstatuar Gjykata Administrative e Apelit. Megjithëse faktet i ka pasqyruar mjaft saktë, Gjykata Administrative e Apelit ka gabuar në interpretimin që i bën ligjit material dhe pikërisht nenit 109/2 të ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, që në këtë rast megjithëse është një ligj material përfaqëson një dispozitë ligjore që ka të bëjë me procedurën e ankimit ndaj një akti administrativ, i cili parashikon se :

Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijani për këtë vendim. Nëse Drejtoria e Apelit Tatimor nuk shprehet brenda tre muajve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankojë drejtpërdrejt në gjykatë. Ligjvënësi në këtë dispozitë ligjore ka parashikuar si rregullin e përgjithshëm ashtu edhe përjashtimin nga ky rregull. Rregulli i përgjithshëm është që pasi merr dijani efektive pra me njoftim nominal dhe jo vetëm paraqitjen në postë të vendimit nga Drejtoria e Apelit Tatimor, subjekti tatimpagues ka të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimit të organit më të lartë administrativ brenda 30 ditëve dhe me kalimin e këtij afati e drejta e padisë parashkruhet (parashkrimi shues). Për të shmangur zvarritjet në marrjen e vendimit nga organi më i lartë administrativ, që në këtë rast është pala e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor, ligjvënësi ka parashikuar se, me kalimin e një afati 3 mujor të mos shprehjes me vendim të organit më të lartë administrativ, Drejtorisë së Apelit Tatimor, subjekti tatimpagues mund t'i drejtohet drejtpërdrejt me kërkesë-padi gjykatës, duke u ankuar ndaj mosveprimit të këtij organi administrativ. Por kjo nuk do të thotë që në këtë rast e drejta e ankimit parashkruhet siç me pa të drejtë ka arsyetuar gjykata e apelit, sepse në rastin që është në shqyrtim organi më i lartë administrativ është shprehur me një vendim pavarësisht, se pas kalimit të afatit tre mujor, pra nuk mund t'i mohohet e drejta e ankimit një subjekti tatimor që të kundërshtojë

në gjykatë një akt administrativ brenda afatit të parashikuar në ligj. Nëse organi më i lartë administrativ nuk do të ishte shprehur fare me vendim, vetëm në këtë rast ka qenë detyrë e gjykatës për të verifikuar nëse ka kaluar afati 3 mujor i ankimit i parashikuar nga neni 109/2 i ligjit nr.9920 dhe pikërisht ky ishte rasti që kërkesë-padinë e "hante" parashkrimi shues. Rasti në shqyrtim nuk është i tillë sepse megjithëse me vonesë organi administrativ është shprehur me një vendim dhe ndaj tij pala e interesuar ka të drejtë që të paraqesë kërkesë-padi në gjykatë brenda afatit ligjor, që është 30 ditë nga marrja e dijensë efektive për vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Për sa më sipër sipas vendimit të Gjykatës së Lartë, Givkata Administrative e Apelit ka qenë e detyruar që të verifikonte ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me vlefshmërinë ose jo të njoftim vlerësimit tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor të lëshuar në emër të palës paditëse Shoqëria "ABs" sh.p.k, pasi kjo gjykatë e ka zgjidhur çështjen në themel, duke u ndodhur përpara një kërkesë padie, e cila është paraqitur brenda afatit ligjor dhe jo të pushonte gjykimin e çështjes, në një kohë kur nuk kanë qenë kushtet e parashikuara në ligj.

Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit : Pranë Gjykatës Administrative të Apelit u shqyrtua kjo çështje në seancë gjyqësore ardhur nga Gjykata e Lartë me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në bazë të ankimit të bërë nga pala e paditur DRT-Shkodër.

Gjykata Administrative e Apelit në zbatim të detyrave të lëna nga Givkata e Lartë ka cituar se :

"Gjykata Administrative e Apelit ka qenë e detyruar që të verifikonte ligjshmërinë e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë në lidhje me vlefshmërinë ose jo të njoftim vlerësimit tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor të lëshuar në emër të palës paditëse Shoqëria "ABs" sh.p.k, pasi kjo gjykatë e ka zgjidhur çështjen në themel duke u ndodhur përpara një kërkesë padie, e cila është paraqitur brenda afatit ligjor dhe jo të pushonte gjykimin e çështjes në një kohë kur nuk kanë qenë kushtet e parashikuara në ligj", e në analizë të Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, të ankimit, të provave dhe fakteve objekt gjykimi bën një vlerësim të ri të provave të ndryshëm nga ai i bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe arrin në konkluzionin, se pretendimet e palës së paditur janë të mbështetura në ligj dhe në prova e si të tilla duhen pranuar duke vendosur ndryshimin e vendimit gjyqësor të shkallës së parë, duke vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Gjykata Administrative e Apelit çmon, se në lidhje me pretendimet e palës paditëse gjykata ka parasysh edhe urdhërimet e Kodit të Procedurave Administrative:

Neni 115 parashikon:

Pavlefshmëria e akteve administrative në kuptim të këtij Kodi paraqitet në format e mëposhtme:

- a) Aktet administrative absolutisht të pavlefshme (aktet e nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin)
- b) Aktet administrative relativisht të pavlefshme (aktet e nxjerra në kundërshtim me ligjin).

Në këto rrethana pala paditëse ka kërkuar pavlefshmerin relative të akteve objekt gjykimi.

Nga kjo gjykatë konform nenit 465 të K.Pr.Civile është çelur pjesërisht hetimi gjyqësor duke ripyetur ekspertin, e cila sqaroi aktin e ekspertimit të hartuar nga ana e saj në seancë gjyqësore gjatë gjykimit në shkallë të parë.

Kjo gjykatë sqaron në vendimmarrjen e saj se natyra e aktivitetit është shërbim ndërkombëtar, i cili shprehet vetëm me faturë të lëshuar nga tatimpaguesi dhe jo si eksport mallrash, të cilat verifikohen përmes DAV doganor, me të drejtë inspektori i kontrollit përmes akt-kontrollit shtesë nr.xxx/1 prot datë 21.03.2011 ka realizuar vlerësim tatimor për shitjet duke i kaluar nga rubrika eksporte në rubrikën shitje të përjashtuara, pasi edhe pretendimi i tatimpaguesit bazuar në nenin 25/9 të ligjit nr.7928 datë 27.04.1995, i ndryshuar, Shërbimet Nderkombetare :

Furnizimi i shërbimeve të bëra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga një person i tatueshëm, vendi i veprimtarisë ekonomike të të cilit është në Shqipëri ose në rastin e një individi, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është në Shqipëri është furnizim i përjashtuar.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 31 ka dalë Udhëzimi nr.31 datë 13.09.2010 "Për përcaktimin e listës së shërbimeve në lidhje me transportin e mallrave dhe pasagjereve dhe shërbimet ndërkombetare të telekomunikacionit si më poshtë:

Shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit:

- a) shërbimi i interkonjeksionit ndërkombëtar;
- b) shërbimi ndërkombëtar "Roaming", i kryer nga një operator vendas për operator të huaj."

Pra është ky udhëzim që ka vendosur, se cila do të jetë lista e shërbimeve me TVSH të zbatueshme dhe meqënëse ky Udhëzim ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr.133 datë 06.10.2010, nga ky moment e tutje shërbimet e interkonjeksionit të kryera prej palës paditëse ACT do të konsiderohen me TVSH të zbatueshme Zero. Ndërsa gjatë periudhës së ndërmjetme nga hyria në fuqi e Ligjit nr.10215 datë 21.01.2010 dhe deri në momentin e hyrjes në fuqi të Udhëzimit nr.31 datë 13.09.2010, shërbimet e interkonjeksionit duhet të konsiderohen si furnizime të përjashtuara, referuar Ligjit nr.7928 datë 27.04.1995 "Për TVSH-në", (ndryshuar me Ligjin nr.10215) neni 25/9.

Lidhur me zgiidhjen sa më drejtë të kësaj çështje gjykata referon në zbatueshmërinë e ligjit nr.7928 datë 27.04.1995 "Për TVSH-në", i ndryshuar.

Kështu në situatën përpara ndryshimeve ne ligj, në Ligjin nr.7928 datë 27.04.1995 "Per TVSH- në", përpara ndryshimeve të datës 21.01.2010 në nenin 31/2 parashikohej se:

"TVSH zbatohet në masën zero përqind, në lidhje me :

- b) Furnizimet e shërbimeve të bëra jashtë territorit të RSH-së nga një person i tatueshëm, vendi i veprimtarisë ekonomike të të cilit ose në rastin e një individi, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është në Shqipëri".

Interkonjeksioni i ofruar nga kompanitë telefonike shqiptare sipas përkufizimit të mësipërm duke u konsideruar shërbim jashtë territorit të RSH-së përpara ndryshimeve të 2010 ishte subjekt me TVSH të aplikueshme zero.

Situata pas ndryshimeve në ligj. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të datës 21.01.2010, neni 31/2, shërbimi i interkonjeksionit shkoi dhe u interpretua në nenin 25/9 si furnizim i përjashtuar, ku parashikohet se:

"Furnizimi i shërbimeve të bëra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga një person i tatueshëm, vendi i veprimtarisë ekonomike të të cilit është në Shqipëri ose në rastin e një individi, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është në Shqipëri është furnizim i përjashtuar".

Pas ndryshimeve të bëra ligjit në fjalë, me Ligjin nr.10215 datë 21.01.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, datë 12.02.2010, neni 31/2 është përpiluar si më poshtë:

"TVSH-ja zbatohet në masën zero përqind:

1. Për mallrat që eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.
2. Për transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve dhe furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me të. Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit kanë të drejtë të caktojnë me Udhëzim të përbashkët cilat janë furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.
3. Për furnizimet e mallrave a shërbimeve në lidhje me veprimtaritë tregtare ose industriale në det.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 31 ka dalë Udhëzimi nr.31 datë 13.09.2010 "Për përcaktimin e listës së shërbimeve në lidhje me transportin e mallrave dhe pasagjerëve dhe shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit, si më poshtë:

Shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit

- a) shërbimi i interkonjeksionit ndërkombëtar;
- b) shërbimi ndërkombëtar "Roaming" i kryer nga një operator vendas për operator të huaj.

Në pikën 19 të Udhëzimit nr.17 dt.30.05.2008 "Për TVSH"- në (akt tashmë i shfuqizuar), parashikohej se:

"Në mbështetje të nenit 33 pika 4, nëqoftëse një furnizim malli apo shërbimi përdoret pjesërisht për qëllime të furnizimeve të tatueshme të bëra ose për t'u bërë dhe pjesërisht për furnizime të përjashtuara, lejohet vetëm një pjesë e kreditimit të tatimit".

Më tej në pikën 19.1.2 të Udhëzimit nr.17/2008 parashikohej se :

"Periudha që merret parasysh për llogaritjen e përqindjes fillestare të kreditimit të tatimit është viti i mëparshëm kalendarik. Në reflektim të zbatimit të nenit 33 të Ligjit nr.7928/1995 dhe pikave 19.1.1 e vijuese të Udhëzimit nr.17 dt.30.05.2008 (të miratuar në bazë e për zbatimin e ligjit), detyrimet tatimore të përcaktuara nga pala e paditur nëpërmjet Njoftim Vlerësimit (objekt ankimi), rezultojnë të jenë përlllogaritur në bazë të kontrollit të plotë tatimor të tatimpaguesit për vitin 2010, sa i takon identifikimit të shërbimeve të interkonjeksionit ndërkombëtar.

Lidhur me furnizimet objekt i kontrollit të palës së paditur, duhet të vihet në vëmendje fakti, se me datë 21.01.2010 rezultojnë të jetë miratuar Ligji nr.10215 dt.21.01.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa

në ligjin nr.7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, hyrja në fuqi e të cilit parashikohet 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare (Neni 9).

Në vlerësim të kësaj gjykate kontrolli tatimor ka konkluduar zbatimin me korrektësi të Nenit 25/9 gjatë kontrollit të ushtruar pranë tatimpaguesit Shoqëria tregtare “ABs” sh.p.k., për konsumatorët e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Por pavarësisht përmbajtjes së Raport Kontrollit mbi deklaratimet e pasqyruara në librat e TVSH-së dhe konfirmimit nëpërmjet tyre të klasifikimit të shërbimeve të interkonjeksionit ndërkombëtar, si furnizim i përjashtuar nga TVSH, paditësi Shoqëria tregtare “ABs” sh.p.k. si në ankimin administrativ në Drejtorinë e Apelit Tatimor ashtu edhe në kërkesë-padi ka ngritur pretendimin, se përçindja e rivlerësuar e kreditimit bazohet në vlerësimin e gabuar të inspektorëve tatimorë, të cilët shërbimet e interkonjeksionit ndërkombëtar i klasifikojnë si furnizime të përjashtuara nga TVSH.

Rrjedhimisht duke iu shmangur përmbajtjes së deklaratimeve të pasqyruara në librat e saj të TVSH-së, pala paditëse në mënyrë të palogjikshme, i kundërtëson palës së paditur me padi të kundërtën e përmbajtjes së dokumentacionit të shoqërisë, duke pretenduar madje mosveprim të administratës tatimore në funksion të korrigjimit kryesisht të deklaratimeve të gabuara të paditësit. Nëpërmjet kërkesë-padisë së saj, pala paditëse ka pretenduar se shërbimet e interkonjeksionit ndërkombëtar dhe ato roaming të furnizuara jashtë territorit të Shqipërisë trajtohen si furnizime të tatueshme, me TVSH në masën 0%, jo vetëm me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.7928/1995, por edhe me ndryshimet e bëra me Ligjin nr.10215/2010.

Për sa më sipër në vlerësimin e palës paditëse, interkonjeksioni ndërkombëtar dhe roaming (shërbimet ndërkombëtare të telekomunikacionit) përbëjnë “transport ndërkombëtar” dhe jo “shërbime të lidhura me transportin ndërkombëtar”, ç’ka përlligj përçindjen e kreditimit të TVSH-se aplikuar prej saj, duke mospërligjur zvogëlimin dhe konvertimin e diferencës në detyrim nga ana e palës së paditur, nuk gjen mbështetje ligjore dhe si i tillë duhet rrëzuar.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson, se pretendimet e ngritura në seancë nga pala e paditur, diktojnë rimarrjen në analizë nën frymën e kuadrit ligjor ekzistues në kohën e ushtrimit prej paditësit të veprimtarisë ekonomike të kontrolluar nga inspektorët tatimorë.

Konkretisht Nenet 25/9 dhe 31 të Ligjit nr.7928/1995, i ndryshuar, bëjnë pjesë në Kreun III me titullin “Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve”.

Sa i takon furnizimeve në Ligjin nr.7928/1995 bëhet klasifikimi i tyre në furnizime të tatueshme dhe në furnizime të përjashtuara.

Konkretisht në Nenin 16, parashikohet se:

"Me furnizim të tatueshëm kuptohet furnizimi i mallrave a shërbimeve, përveç furnizimeve të përjashtuara, ndërsa më tej në nenin 19 parashikohet se :

1. Furnizimi është një furnizim i përjashtuar nëse ai përcaktohet në nenet 20 deri në 25 dhe në nenet 25.1, 25.2, 25.3, 25.5, 25.6, 25.7, 25.8, 25.9, 25.10, 25.11 dhe 26.1 të këtij ligji.

Referuar dispozitave ku referon Neni 19, rezulton që ligjvënësi të ketë konsideruar si furnizime të përjashtuara, tokat dhe ndërtesat (20), shërbimet financiare (21), bankat (22), shërbimet postare (23),

organizatat jofitimprurëse (24), diplomatët (25), operacionet hidrokarbure (25.1), ambalazhet dhe materialet e barnave (25.2), shitjet e librave gazetave etj (25.3), furnizimet falas (25.5), furnizimet e shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të destinuara për t'u rieksportuar për personat e tatueshëm të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv (25.6), furnizimet e shërbimeve të lojrave të fatit (25.7), furnizimin e kartave të identitetit (25.8), hekurin dhe çimento (25.10), barnat, shërbimin shëndetësor, lëndët e para në bujqësi dhe kafshët e racës (25.11) si edhe furnizimet e përjashtuara në import (26.1).

Shërbimet e interkonjeksionit ndërkombëtar si furnizime që nuk përkojnë me asnjërin prej furnizimeve të përcaktuara në dispozitat e sipërcituara, përfshihen pashmangshmërisht në furnizimin "shërbime ndërkombëtare" parashikuar në nenin 25/9 si furnizim i përjashtuar nga TVSH.

Për sa më sipër kontrolli tatimor duke konstatuar se shërbimet e interkonjeksionit ndërkombëtar, si furnizim shërbimesh jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ofroheshin përgjatë periudhës viti 2010 nga një shoqëri që kishte Shqipërinë si vend të ushtrimit të veprimtarisë së saj ekonomike, e kanë klasifikuar shërbimin e ofruar si furnizim të përjashtuar nga TVSH. Thënë ndryshe klasifikimi i interkonjeksionit ndërkombëtar si furnizim i përjashtuar nga TVSH rezultojnë të jetë diktuar nga vlerësimi i kryerjes në rastin konkret të një furnizimi nga një operator vendas, për operatorët e huaj. Ky përfundim sipas gjykatës rezultojnë të jetë diktuar edhe nga fakti i mospërcaktimit në një dispozitë të veçantë i furnizimeve të mallrave e të shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve me TVSH në masën zero përqind, duke ia njohur Ministrin të Financave dhe Ministrin të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit kompetencën e parashikimit të përcaktimeve konkrete nëpërmjet udhëzimeve të përbashkëta.

Bazuar në kuadrin ligjor ekzistues në periudhën vitin 2010 organet tatimore nuk mund të klasifikonin shërbimet e ofruara nga paditësi për operatorët jo vendas si furnizime me TVSH në masën zero përqind. Ndryshe nga sa pretendon paditësi është pikërisht Udhëzimi nr.31/2010 akti nënligjor që bën diferencën sa i takon klasifikimit të furnizimeve me TVSH 0%, duke përfshirë shprehimisht në këtë kategori edhe shërbimet e interkonjeksionit ndërkombëtar dhe roaming. Konkretisht referuar përmbajtjes së Raport Kontrollit rezultojnë të jetë konstatuar, se tatimpaguesi Shoqëria tregtare "ABs" sh.p.k shërbimet e interkonjeksionit ndërkombëtar, pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit nr.31 dt.13.09.2010 i ka klasifikuar si furnizime të tatueshme me TVSH 0%, duke i deklaruar si të tilla në organet tatimore. Vetëm në Udhëzimin nr.31 dt.13.09.2010 "Për përcaktimin e listës së shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar detar, ajror dhe të telekomunikacionit, të mallrave dhe pasagjerëve me tvsh zero", shërbimet e interkonjeksionit ndërkombëtar dhe ato roaming, të furnizuara nga operatorët vendas për operatorët e huaj, klasifikohen si furnizime të tatueshme me TVSH 0% dhe se për periudhën e ndërmjetme nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.10215 dt.21.01.2010 (që amendonte Ligjin nr.7928/1995 "Për TVSH"- në) deri në momentin e hyrjes në fuqi të Udhëzimit nr.31/2010 këto shërbime duhej të trajtoheshin si shërbime të përjashtuara nga TVSH.

Në përfundim të pasqyrimin të fakteve të mësipërme rezultojnë, që kontrolli tatimor gjatë vizitës fiskale të ketë konstatuar klasifikime dhe deklarime të diferencuara nga pala paditëse, para dhe pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit nr.31/2010 duke i klasifikuar dhe deklaruar shërbimet e interkonjeksionit ndërkombëtar dhe ato roaming si furnizime të përjashtuara nga TVSH para hyrjes në fuqi të Udhëzimit dhe si furnizime të tatueshme me TVSH 0%, pas hyrjes së tij në fuqi.

Në këto kushte dhe rrethana Gjykata e Apelit vlerëson, se padia e palës paditëse është e pambështetur në ligj dhe prova dhe si e tillë duhet rrëzuar.

Gjykata Administrative e Apelit çmon, se Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural, por në vlerësim të gabuar të provave dhe ligjit material dhe si i tillë duhet të ndryshohet duke vendosur pranimin e plotë të ankimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe prova.

Vendim:

Ndryshimin e vendimit nr.1576 datë 27.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Rrëzimin e padisë së ngritur nga pala paditëse shoqëria tregtare “ABs” sh.p.k. si të pabazuar në ligj e në prova.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë brenda 30 ditëve duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.

3.2.2. ÇËSHTJE TË HETIMIT TATIMOR

3.2.2.1. Vendim nr. 2752, datë 06.07.2018

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria "XXX" Sh.p.k

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

Drejtoria e Apelimit Tatimor, Tiranë.

Objekti: Shfuqizimi i Akt Konstatimit me Nr._____, datë 15.07.2014.

Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit për Detyrimet me Nr._____ Prot, datë 17.09.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

Shfuqizimin e vendimit Nr._____ Prot, datë 08.01.2015, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: 500.000 lekë.

Baza Ligjore:

1. Nenet 19 dhe 158 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".
3. Nenet 25 dhe 27 të ligjit Nr.49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gykimin e Mosmarrëveshjeve administrative".

Përmbledhje e Fakteve: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me Vendimin Nr.____ Dt.19.06.2015, ka vendosur: “Rrëzimin e Padisë si të pabazuar në prova dhe në Ligj”. Kundër këtij Vendimi ka paraqitur Ankim pala paditëse me pretendimet se:

Personi i cili është shënuar në akt konstatim z. YYY nuk është punonjës pranë subjektit paditës por është një i afërm i familjes i cili gjendej rastësisht si shofer. Z.YYY nuk rezulton të jetë punonjës në asnjë subjekt pasi ai përfiton pension pleqërie. Dokumentacioni që e vërteton këtë të dhënë është paraqitur gjatë gjykimit në shkallë të parë së bashku me kërkesëpadinë.

Nga ana tjetër nga ana e Inspektorëve të Sektorit të Verifikimit në Terren, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në datë 15.07.2014, është ushtruar kontroll në automjetin me targë DR ____ E, i cili transportonte ngarkesë të pajisur me faturë tatimore me Nr. Serie _____. Ky automjet drejtohej nga shtetasi YYY, me ID _____. Këto fakte janë pasqyruar në akt-konstatimin Nr. _____, datë 15.07.2014, të nënshkruar nga tre inspektorë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ndërkohë që shtetasi YYY ka refuzuar të nënshkruajë.

I njëjti automjet është kontrolluar sërish nga Inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në datë 17.07.2014, ku kanë rezultuar të njëjtat fakte si dy ditë më parë, që mjete ishte me ngarkesë, me faturë tatimore Nr. serie _____ dhe drejtohej nga shtetasi YYY, i cili nuk ka nënshkruar përsëri.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata Administrative e Apelit, gjatë shqyrtimit të çështjes ka konkluduar se:

Nga listëpagesat e dorëzuara nga pala e paditur, për këtë periudhë (korrik 2014), ka rezultuar se punonjësi i gjetur në punë Z. YYY, nuk ishte i deklaruar në skemën e punësimit të sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.

Pala paditëse, Shoqëria "AB" Shpk. nëse donte të provonte të kundërtën e fakteve të provuara nga inspektorët tatimorë, ajo duhet të pretendonte falsitetin e këtij akti zyrtar me fuqi të plotë provuese. Pala paditëse nuk ka zgjedhur rrugën e parashikuar nga ligji për të vërtetuar të kundërtën e fakteve të provuara në përputhje me ligjin procedural civil nga pala e paditur, Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës. Ajo, si në gjykimin në shkallë të parë ashtu edhe në ankimin e paraqitur, ka pretenduar se ky shtetas ndodhej rastësisht në mjet meqënëse ishte i afërm i administratorit të shoqërisë. Ky pretendim i palës paditëse është haptazi i pabazuar për sa kohë në gjykim është provuar se shtetasi YYY, është konstatuar dy herë brenda tre ditësh duke drejtuar të njëjtin mjet të shoqërisë, duke transportuar mallrat për llogari të saj.

Ky kolegji thekson se, kjo sjellje e tatimpaguesit është e kundërligjshme dhe e sanksionueshme me gjobë në masën 500,000 lekë, sipas nenit 119, të ligjit Nr. 99201/2008, i ndryshuar (në fuqi në kohën e kryerjes së kundërvajtjes administrative tatimore). Këtë shkelje të palës paditëse, pala e paditur, Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, në zbatim korrekt të ligjit për Procedurat Tatimore ja ka njoftuar palës paditëse, nëpërmjet vlerësimit tatimor Nr. _____ prot.. datë 17.09.2014.

Vendim:

- Lënien në fuqi të vendimit Nr.____, Dt.19.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Kundër vendimit nuk mund të ushtrohet rekurs.

3.2.2.2. Vendim nr. 3161, datë 17.09.2018

Paditës: Subjekti “XXX” sh.p.k

I paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

Objekti: Kundërshtimi i Njoftim Vlerësimit për detyrimet tatimore me nr. _____ Prot, datë 02.09.2016 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe i vendimit nr. _____ Prot, datë 02.01.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimor: 1000.000 lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar përkatësisht Neni 80, neni 108 pika 5, 119, pika 1 gërma (b);
2. UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pika 80.3 (c), 108.5;
3. Udhëzimi nr. 23 datë 09.12.2014 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në RSH” pikën 6.2;
4. Ligji 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”, i ndryshuar nenet 2,7 e 9;
5. ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në RSH”, i ndryshuar nenet 7 e 8
6. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Përmbledhje e Fakteve: Ndaj subjektit “XXX” sh.p.k me Nipt _____ Inspektorët e Task Forcës pranë DPT kanë ushtruar një kontroll në ambjentet e subjektit në bazë të Urdhrit të Shërbimit me Nr. _____ Prot, datë. 30.07.2015. Mbi bazën e kontrollit të ushtruar në shoqërinë “XXX” sh.p.k është mbajtur Akt-Konstatimi me nr. Serial _____, datë 30.07.2015 ku rezultoi se: “...në momentin e kontrollit në punë u gjetën këta punonjës YY e dtl. 27.09.1990, ZZ i dtl. 02.05.1992...”. Akt Konstatimi i mbajtur është përcjellë për procedura të mëtejshme në Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, është bërë verifikimi nga inspektori i dosjes në sistemin C@TS dhe ka rezultuar se punonjësit YY e dtl. 27.09.1990, ZZ i dtl. 02.05.1992, nuk janë deklaruar në administratën tatimore. Në bazë të Akt konstatimit të mbajtur, është mbajtur dhe Proces-Verbal Gjore me nr. Serial _____ datë 26.08.2015, ku në bazë të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 119, pika 1 gërma (a), subjekti është penalizuar me gjobë në masën 1000.000 lekë për mosdeklarim të punonjësve në organin tatimor. Për këtë penalitet subjekti është njoftuar nëpërmjet Njoftim Vlerësimit nr. _____ Prot, datë 02.09.2016 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë”.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata ka vlerësuar se vendimi nr. _____, datë 16.03.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit në raport me faktet dhe provat në gjykim dhe ka vend për t’u ndryshuar duke u vendosur rrëzimi i padisë. Gjykata Administrative e Apelit ndryshe nga Gjykata e Shkallës së Parë vlerëson se asnjë parregullësi procedurale e kryer nga pala e paditur nuk konstatohet në rastin konkret. Zhvillimi i gjykimit në shkallë të parë ka vërtetuar se shoqëria paditëse nuk kishte deklaruar në afatin ligjor 24 orë para punësimit dy punonjës, fakt ky i cili përmbush situatën e parashikuar nga neni 119 i Ligjit nr. 9920/2008 i ndryshuar. Njoftim Vlerësimi dhe Vendimi i DAT Tiranë janë akte administrative të nxjerra në formën e kërkuar nga ligji dhe kanë dalë si rrjedhojë e respektimit të procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, dalë në zbatim të tij.

Vendim: Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.____, datë 16.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
Rrëzimin e Kërkesë Padiisë.

3.2.2.3. Vendim nr. 1055, datë 18.09.2018

Paditës: XXX sh.p.k

I paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

Objekti: Shfuqizim i shkresës me nr. ____ prot, datë 24.01.2018 me lëndë “Njoftim vlerësimi” e Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë e cila përmban gjobë në masën 200 000 lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën dhjetor 2017.

Shuma e detyrimit tatimor: 200 000 lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar përkatësisht: Neni 80, neni 108 pika 5, 119, pika 1 gërma (a);
2. UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pika 80.3 (c), 108.5;
3. Pika 4.1 e Udhëzimit Nr 23 datë 09.12.2014 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”, dalë në zbatim të ligjit Nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar
4. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
5. Ligji Nr.9136, date 11.9.2003, i ndryshuar, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” në neni 11 pika 3;

6. VKM nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, në kreun I, pika 1, gërma (ç) , pika 7 e 8.

Përmbledhje e Fakteve: Ndaj subjektit “XXX” sh.p.k me Nipt_____, Inspektorët e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor, Fier kanë ushtruar një kontroll në ambjentet e subjektit në bazë të Urdhër Shërbimit nr.____ prot, datë 31.10.2017. Mbi bazën e kontrollit të ushtruar në shoqërinë “XXX” sh.p.k është mbajtur Akt-Konstatimi me nr.____ të datës 14.11.2017 ku rezultoi se: “...në punë u gjet z. GF, shtetas italian me numër pashaporte U_____JK i datëlindjes 02.08.1964 i padëklaruar në organet tatimore, pasqyruar në P.V.GJ me nr. serie _____ datë 14.11.2017...”. Akt Konstatimi i mbajtur është përcjellë për procedura të mëtejshme në Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, është bërë verifikimi nga inspektori i dosjes në sistemin C@TS dhe ka rezultuar se punonjësi z. GF nuk ishte deklaruar në organin tatimor. Në bazë të Akt konstatimit të mbajtur është mbajtur dhe Proces Verbal Gjobë me nr. serie _____, datë 14.11.2017 ku rezulton se tatimpaguesi është penalizuar me gjobë bazuar në nenin 119 pika 1 gërma a) të Ligjit Nr.9920/2008 i ndryshuar, për punonjës të padëklaruar. Pala paditëse ka pretenduar se: “Z. GF shtetas italian me numër pashaporte U_____JK nuk është punonjës i kompanisë tonë. Me të ne kemi lidhur një kontratë bashkëpunimi për të verifikuar cilësinë e produkteve që eksportojmë pasi teknikët tanë, O.M dhe S. C (shtetas italianë por që sigurohen nga shoqëria jonë) për arsye shëndetësore ishin larguar në Itali. Për kontratën e shërbimit të lidhur me Z. GF kemi deklaruar dhe paguar tatim në burim”. Pretendimet e palës paditëse vijnë në kundërshtim me Ligjin 9920/2008 i ndryshuar dhe VKM nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, në kreun I, pika 1, gërma (ç) , pika 7 përcakton se: “7. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar në subjekte të regjistruara për efekte fiskale në Republikën e Shqipërisë, mbrohen dhe sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, sipas përcaktimeve në pikën “1”, të këtij kreu”.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova dhe në ligj. Pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara dhe referuar kontratës së shërbimit të lidhur midis Shoqërisë “XXX” sh.p.k dhe z.GF ajo është një kontratë punësimi pavarësisht emërimit që i kanë vendosur palët pasi ka objekt ofrimin e një shërbimi kundrejt pagesës nga ana e punëdhënësit. Gjithashtu kjo kontratë nuk ka nënshkrimin e punëmarrësit dhe për këtë arsye është konsideruar nga gjykata si një kontratë e palidhur pasi nuk shpreh vullnetin e punëmarrësit. Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret pala paditëse duhet ta deklaronte si të punësuar pranë organeve tatimore shtetasin GF, veprim të cilin paditësi nuk e ka kryer dhe i cili ka sjellë pasojën e sanksionimit me gjobë. Sa më sipër Gjykata vlerëson se kërkimet e paditësit për shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi dhe Vendimit të DAT Tiranë është e pabazuar pasi aktet administrative objekt gjykimi janë nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar si dhe nenit 107 të Kodit të Procedurave Administrative.

Vendim: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur:
Rrëzimin e Kërkesë Padisë.

3.2.2.4. Vendim nr. 3356, datë 27.09.2018

Paditës: E.B

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekti: Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimit nr.____ prot, datë 09.12.2014 të Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë; Shfuqizimi i gjobës në masën 1.500.000 lekë, njoftuar me aktin nr.____ prot, datë 07.08.2014; Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër

Shuma e detyrimit tatimor: 1 500 000 lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 119, pika 1, gërma (b)

Përmbledhje e Fakteve: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime vlerësuar sipas Njoftim-Vlerësimit nr.____ prot, datë 07.08.2014, gjobë në vlerën totale 1 500 000 lekë, dënim për gjashtë “punonjës të padeklaruar” para organit tatimor.

Në zbatim të Urdhrit të punës nr.____ prot, datë 11.07.2014 grupe pune të organit tatimor kanë ushtruar kontroll pranë subjekteve që ushtrojnë aktivitet tregtar në Qarkun e Shkodrës, në zbatim të ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, i ndryshuar. Kontrolli u ushtrua dhe pranë subjektit “E.B” me numër Nipti L _____ S, me adresë Zues, Shkodër, objekt veprimtarie “bar – restorant”. Pas kontrollit të ushtruar Grupi i punës së organit tatimor ka mbajtur Akt konstatimin me numër serie _____, datë 11.07.2014 referuar përmbajtjes së të cilit:

“Nga kontrolli i ushtruar rezultoi:

1.....

2.....

4. Në momentin e kontrollit u gjendën duke punuar:

- A. B
- M. D
- Sh. D
- S. H
- E. M
- E. Rr
- S. M

Kontrolli u krye në orën 15.20”Detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor janë të përcaktuara qartë në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH-së”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, “Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore”.

Detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Hetimit Tatimor janë të përcaktuara qartë në nenin 105 të Ligjit nr. dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, V.K.M-ve nr.400 datë 22.04.2009 “Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor” dhe në “Manualin e Veprimtarisë së Hetimit Tatimor”, “Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore”. Me shkresën nr. ___ prot, datë 11.07.2014, Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë D.R.T Shkodër i kalon për ndjekje të mëtejshme, Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit po pranë D.R.T Shkodër, Akt konstatimin e mbajtur me numër serie _____ datë 11.07.2014 pranë subjektit tregtar “E.B” me numër Nipti L _____ S për të verifikuar nëse punonjësit e listuar në këtë Akt Konstatim janë të deklaruar sipas legjislacionit fiskal.

Nga Drejtoria e Vlerësimit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në vijim të procedurave ligjore, mbi bazën e informacionit sipas përmbajtjes së këtij Akt konstatimi është bërë verifikimi i të gjithë punonjësve të deklaruar si “të punësuar” nga subjekti “E.B” me numër Nipti L _____ S para organit tatimor, detyrim ligjor ky për të.

Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur është vlerësuar se ndër punonjësit e gjendur në punë sipas Akt konstatimit të lartpërmendur, z.A.B, z.M.D, z.Sh.D, z.E.M, z.E.Rr dhe z.S.M nuk ishin deklaruar në organin tatimor nga subjekti konform rregullave dhe afateve ligjore; ata nuk rezultojnë të ishin përfshirë në deklaram para organit tatimor.

Nga Drejtoria e Vlerësimit është adresuar shkresa nr. ___ prot datë 24.07.2014, Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Sektorit të verifikimit në terren nëpërmjet së cilës bëhet e ditur, se subjekti nuk ka të deklaruar punonjësit në fjalë, pra gjashtë punonjës dhe në vijim kërkohet të merret masa e gjobës, sanksionit në zbatim të ligjit.

Në zbatim të Urdhrit të punës nr. ___ prot, nr.823 prot datë 31.07.2014 grupi i punës së organit tatimor ka mbajtur pranë subjektit Akt Konstatimin me numër serie _____ datë 31.07.2014 dhe në vijim Procesverbalin e Gjobës me numër serie _____ datë 31.07.2014, sipas të cilit subjekti paditës sanksionohet me gjobë për punonjës të padeklaruar në zbatim të legjislacionit fiskal.

Me shkresën nr. ___ prot datë 04.08.2014 njoftohet Drejtoria e Vlerësimit me Akt konstatimin me numër serie _____ datë 31.07.2014 dhe Procesverbalin e gjobës me numër serie _____ datë 31.07.2014, sipas të cilit subjekti “E.B” vlerësohet me gjobë në vlerën totale 1.500.000 lekë për punonjës të padeklaruar në organin tatimor.

Vlerësimi i gjobës është bazuar në nenin 119 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH-së”, i ndryshuar.

Neni 119 i këtij ligji shpreh :

1.Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimit mbi Fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 124/2012, dt. 20.12.2012. Botuar ne Fl.z. nr. 177, dt. 09.01.2013).

Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, pika 119. “Mosdeklarimi i të punësuarve” shpreh :

119.1 Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta. Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), që fillojnë punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre. Ky deklaram duhet të bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve. Në mbështetje të nenit 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, punonjësit e administratës tatimore, të autorizuar me shkrim, kryejnë verifikime e kontrole në vendndodhjen e biznesit lidhur me deklaramin e numrit të punonjësve. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar, që fillon punë për herë të parë te tatimpaguesi apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së të vetëpunësuarit me të cilët ai punon e bashkëjeton), përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të papaguara të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimpaguesi përkatës detyrohet të paguajë edhe një gjobë prej:

a) 500 000 (pesëqind mijë) lekë kur është tatimpagues i regjistruar njëkohësisht për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimin mbi Fitimin,

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

Në Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 80.3 shprehet :

Kontrollet tatimore janë :

a) *Kontroll tatimor i plotë në vend.* Këto kontrole janë gjithëpërfshirëse dhe ndërmerren për të kontrolluar te gjitha aspektet e biznesit te personit te tatueshëm për te gjitha periudhat kohore qe nga kontrolli i plotë i fundit dhe të gjithë llojet e tatimeve. Këto kontrole kryhen bazuar në analizën e riskut.

b) *Vizitat fiskale.* Këto janë kontrole te shkurtra te kryera gjatë një periudhe te shkurtër kohore për te verifikuar saktësinë e deklaratave dhe pagesave, si rregull vetëm për një periudhë te caktuar tatimore

dhe vetëm për një lloj tatimi.

c) Verifikimet ne vend. Këto verifikime te shkurtra synojnë zbulimin në kohë të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave te tatueshëm (identifikimin e personave te paregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin e faturave tatimore, etj. **Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdhrin e ditës, te lëshuar nga drejtuesi i Drejtorisë se Kontrollit për verifikime ne vend.**

Në nenin 68 të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar “**Vlerësimi tatimor**” shprehet :

1. Vlerësimi tatimor

a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore.

5. Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në :

a) informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit

b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji

c) mënyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji.

7. Kur një vlerësim bëhet në përputhje me shkronjat “b” ose “c” të pikës 5 të këtij neni, barra e provës, që shuma e këtij vlerësimi është e pasaktë, bie mbi tatimpaguesin.

Detyrimet e vlerësuara sa më lart janë hedhur në sistemin informatik tatimor dhe në vijim janë pasqyruar në njoftim vlerësimin objekt gjykimi dhe i janë njoftuar subjektit, konform procedurave ligjore. Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me një kërkesë ankimore në lidhje me këtë vlerësim.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar me shkresën nr.____ prot datë 09.12.2014 subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos :

Lënien në fuqi të detyrimeve në shumën 1 500 000 lekë përcaktuar në aktin administrativ,

njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr.____ datë 07.08.2014 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, për mosdeklarim punonjësish pranë organit tatimor.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës se Parë Shkodër me vendimin nr.____ datë 22.06.2015 ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesëpadisë.

2. Shpenzimet gjyqësore siç jane bërë.

3. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve nga e nesermja e shpalljes ne Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Pala paditëse ka ankimuar vendimin.

Gj.Ad.e Apelit me vendimin nr.3356 datë 27.09.2018 vendosi :

Lënien në fuqi të vendimit të Gj.Ad.Sh.P.Shkodër.

Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit çmon, se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër nr. ____ date 22.06.2015 është i drejtë dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Vendimi objekt ankimi është rrjedhojë e analizës së drejtë të provave dhe zbatimit korrekt të ligjit, për rrjedhojë shkaqet e ngritura në ankim nga pala paditëse për ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë nuk qëndrojnë.

Ndër të tjera Gjykata Administrative e Apelit arsyeton në vendimmarrjen e saj, referuar nenit 80 të ligjit Nr.9920/2008, pikes 80.3. c dhe 119 të Udhëzimit Nr.24 date 2.9.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, se inspektorët e DRT Shkodër kanë kryer kontrole pranë paditësit në lidhje me zbatimin e legjislacionit tatimor (nenet 116, 119 të ligjit nr.9920/2008), nëpërmjet procedurës së “verifikimit në vend” kontroll, i cili kryhet pa njoftimin paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës të lëshuar nga drejtuesi i Drejtorisë së Kontrollit për verifikime në vend; kërkesa, të cilat referuar provave të marra në shqyrtim rezultojnë se janë respektuar gjatë kryerjes së kontrollit nga inspektorët e kontrollit .Pala paditëse nuk ka paraqitur prova për të hedhur poshtë përmbajtjen e aktit të konstatimit të datës 11.07.2014, pasi paditësi ka refuzuar nënshkrimin e tij dhe procesverbali është nënshkruar rregullisht nga ana e inspektorëve të palës së paditur. Në të pasqyrohen emrat e punonjësve të gjetur në punë gjatë inspektimit dhe puna që kryhej nga secili prej tyre. Për pasojë procedura në këtë rast vlerësohet të jetë respektuar nga pala e paditur.

Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes administrative është mbajtur në përputhje me nenet 13 dhe 14 të ligjit “Për kundërvajtjet” Nr.10 279/2010 duke qenë, se ai është mbajtur nga personat e ngarkuar me ligj në vendin ku është konstatuar shkelja, vend në të cilin rezultojnë të ketë ushtruar veprimtarinë ekonomike pala paditëse; procesverbalet përshkruajnë faktin konkret të konstatuar, ato janë nënshkruar nga përpiluesit, ndërkohë që refuzimi i nënshkrimit nga subjekti i kontrolluar nuk përbën shkak për pavlefshmerinë e tij. Akti i konstatimit pasqyron emrat e saktë të 6 punonjësve të gjetur në punë, të cilët sipas verifikimeve me deklaratimet e shoqërisë në formularin E-sig 025 të muajit korrik/2014 nuk rezultojnë të jenë deklaruar të paktën 24 orë para fillimit të punës.

Pretendimi i paditësit se personat e gjetur në vendin e biznesit të tij ishin duke u testuar për t'u punësuar janë pretendime të pambështetura në prova.

Sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit vlerëson, se masa e gjobës ndaj paditësit në masën 1 500 000 lekë për punonjës të padeklaruar është vendosur nga pala e paditur në përputhje me kërkesat e nenit 119/1/b të ligjit Nr.9920/2008.

Pretendimet e paditësit se me ndryshimet e nenit 119/1/b të ligjit Nr.9920/2008 masa e gjobës nuk është 250 000 leke e për pasojë me aktin objekt kundërshtimi nuk është vendosur gjoba në përputhje me ligjin, Gjykata Administrative e Apelit i vlerëson si të pambështetura në ligj.

Gjykata evidenton se me ligjin nr.164/2014 datë 04.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin

25 të tij përcaktohet se:

“Në nenin 119, pika 1, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme :

“1.Shkronja "b" ndryshohet si më poshtë :

"b) tatimpaguesit e tjerë me gjobë prej 50 000 (pesedhjetë mijë) lekësh.

2. Në fund te pikës shtohet një paragraf me këtë përmbajtje :

“Çdo konstatim i përsëritur i mosdeklarimit të punonjësve pas aplikimit të dënimit administrativ si në pikën 1 të këtij neni, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 te ligjit dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131 të këtij ligji, duke bërë kallëzimin penal për tatimpaguesin”

Ky ligj është botuar ne fletoren zyrtare Nr.198 datë 30.12.2014 dhe nuk ka fuqi prapavepruese për kundërvajtjet e kryera para hyrjes në fuqi të tij.

Vendim:

- Lënien në fuqi të vendimit Nr.____ datë 22.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

3.2.3. ÇËSHTJE TË TJERA

3.2.3.1. Vendim nr.3606 , datë 15.10.2018

Padites: Shoqëria “XXX” sh.a.

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan.

2. Drejtoria e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë

Objekti: Detyrimi i Palës së Paditur Drejtoria Rajonale Tatimore -Elbasan të rimbursojë TVSH-në e miratuar për rimbursim në shumën 5.730.921 lekë, TVSH e vlerësuar sipas Njoftim Vlerësimit të TVSH-së së vitit 2001, si dhe kamatat e arrira (interesat bankare) nga data e lindjes së detyrimit deri në ekzekutimin e tij.

Shfuqizim i vendimit nr.____ prot, datë 22.10.2014 të DAT, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shuma e detyrimit tatimor: 5.730.921 lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurën Tatimore në RSH” i ndryshuar
2. Ligjin Nr.10261, datë 01.04.2010). Nenet 419, 420, 445 e vijues të Kodit Civil;
3. Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.24, datë 02.09.2008 (i ndryshuar) ;
4. Udhëzimi Nr.17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në” ;
5. Ligji Nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Permbledhje e Fakteve: Shoqëria XXX sh.a kërkonte rimbursimin e TVSH-së në shumën prej 5.730.921, që i përkiste periudhës së muajit Mars të vitit 2001, sipas proceverbalit të datës 28.03.2001. Shoqëria vazhdonte të kryente aktivitetet dhe krijonte teprica të reja kreditore, gjithashtu për këto periudha që shoqëria XXX sh.a kryente aktivitetet, i lindnin dhe detyrime.

Në vitin 2005 midis shoqërisë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore -Elbasan lidhet një akt marrëveshje, dhe në të përcaktohet që të bëhet likuidim midis detyrimeve që ka shoqëria dhe tepricës kreditore të krijuar ndër vite të TVSH-së. Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan i rimbursion një pjesë të tepricës kreditore dhe shumën e mbetur prej tepricës kreditore sipas pretendimit të palës që ishte në vlerën 5.730.921 nuk i ishte rimbursuar, për vitet ushtrimore 2001-2005. Shoqëria ka pasur dhe detyrime ndaj Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan dhe kjo shumë e pretenduar si e pakthyer nga shoqëria, duhet të ishte përdorur për mbylljen e detyrimeve.

Shoqëria XXX sh.a këtë shumë prej 5.730.921 lekë të pretenduar nga ana e saj si e pakthyer bën kërkesë për rakordimim dhe rimbursim me shkresat Nr. ___ prot, datë 03.03.2014 dhe Nr ___ prot, datë 17.07.2014. Aktet shkresore i ankimon në rrugë administrative pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor. DAT-Tiranë del me vendim Nr.____ prot 22.10.2014 duke lënë në fuqi aktet shkresore të Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan dhe lënë si detyrë rakordimin e situatës ndërmjet Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan dhe shoqërisë XXX sh.a

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë në vlerësimin e saj, referuar akteve të paraqitura përgjatë seancave gjyqësore ka vlerësuar që është parashkruar e drejta e ngritjes së padisë nga shoqërisë XXX sh.a

Vendim:

Prishjen e Vendimit Nr____, datë 10.03.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Pushimin e Gjykimit të çështjes në këtë Gjykatë.

3.2.3.2 Vendim nr.1425 , datë 13.11.2018

Paditës : Subjekti “XXX”shpk

I paditur : Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, Adresë : Lagjja “30 Vjetori” Berat.

Objekt : Kundërshtim i pjesshëm i akteve administrative

Arsyetimi i Gjykatës: Pala paditëse pretendon se akti administrativ i nxjerrë nga organi publik është një akt administrativ i marrë në kundërshtim me ligjin, si rrjedhim, ai duhet të shfuqizohet.

Gjykata vlerëson se ky pretendim i palës paditëse duhet të pranohet. Kjo për arsyen se, organi

administrativ në nxjerrjen e aktit administrativ përkatës nuk ka respektuar të katër kriteret e vlefshmerise së aktit administrativ.

Së pari, kriteri i përputhshmerise së aktit administrativ me ligjin, nuk është zbatuar plotësisht në rastin konkret. Neni 35 i Ligjit nr.8438/1998 u njeht paguesve të detyrimeve të mbajnë tatimin në burim dhe t'ia vendosin në dispozicion ato organeve tatimore. Ky detyrim, sipas nenit 33 të të njëjtit ligj rëndon mbi të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organe te qeverisjes vendore e qendrore, organizata fitimpruese e cdo subjekt tjetër, ne masen 15% nga shuma bruto e pagesave që lindin nga detyrimi. Nga një interpretim literal që mund t'i bëhet këtyre dispozitave është se, ky detyrim vlen vetëm atëhere kur bëhet pagesa për detyrimin e lindur dhe jo detyrimisht një herë në muaj. Në rastin konkret, kontrata e qirasë e lidhur midis subjektit paditës e personave të tretë, mban datë 24.12.2016 dhe në paragrafin 2 e 3 të saj sanksionon se, vlera e qirasë do të jetë 3000 (*tre mijë*) lekë në muaj e do të paguhet një herë në vitë ose një herë në gjashtë muaj.

Kjo kontrate rezulton se është deklaruar në kohë pranë organeve publike (*viti 2016*), si rrjedhim, ky organ nuk mund ta tarifojë këtë subjekt, duke edhe e sanksionuar për mosdeklarim në kohë të tatimit mbi të ardhurat për aq kohe sa ky detyrim nuk është kryer (*duhet të kryhet në fund të vitit 2017*).

Nga ana tjetër, u vertetua në gjykim edhe pretendimi tjetër se, edhe pse kerkesa për hapjen e përgjegjesisë tatimore për pagimin e fitimit të detyrimit të mbajtur në burim është depozituar nga pala paditëse me datë 17.02.2017, është hapur nga ana e inspektoreve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat rreth një viti më vonë, me datë 23.02.2018, duke i njohur këtij veprimi fuqi prapavepruese. Kjo mënyrë veprimi e ka konsideruar përgjegjës subjektin paditës për mosdeklarim në kohë të detyrimit ligjor, por që në fakt ky subjekt nuk ka pasur mundësi për t'i deklaruar ato në kohën e duhur për shkak të problemeve teknike të ardhura nga vetë organi administrativ. Si rrjedhim, nuk mund të ngarkohet subjekti tatimpagues për këtë anomali të ardhur nga mosveprimet e organit administrativ.

Në rrethanat kur, për vlefshmerinë e një akti administrativ duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të katër kriteret dhe ku rezultoi se të paktën njeri prej tyre nuk u plotësua (*përputhshmëria e aktit administrativ me ligjin*), Gjykata cmon se, për ekonomi gjyqësore mos t'i marrë në shqyrtim kriteret e tjere të vlefshmerisë së aktit administrativ.

Përsa u argumentua më sipër, në kushtet kur akti administrativ i vendosjes së dënimit administrativ nuk përmbush të gjitha kriteret e vlefshmerise së aktit administrativ, Gjykata konkludon se, padia duhet të pranohet duke u vendosur shfuqizimi i aktit administrativ të kundërshtuar nga pala paditëse.